

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Serbët e Kosovës mes listës së Vuçiqit dhe asaj studentore
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/kosova/politike/serbet-e-kosoves-mes-listes-se-vuciqit-dhe-asaj-stud-i1185816
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 06:41:51 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 06:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a9d075d2c6588497f07396a3b546f96e59f1c9f96defa89f286a2b96df8daa25
TEKSTI	b518d0d0877f79264ac36b264065af89ebe9152f099864bf1dd08846f6a0e635
PAMJA	7ce120e445c61261202fd10150c2dc13d706e8a3266e7b89587ddd3e4eaa8409

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	07ac56d326f03be84c9bc20157c0ac718a8ac7f2d9bcb846eb03b050355ae4b2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	491fbc2f0e2919ed311b022f1b5f92632a55c8ad6fb3d3a6ed9398e35c5643c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/07ac56d326f03be84c9bc20157c0ac718a8ac7f2d9bcb846eb03b050355ae4b2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Serbët e Kosovës mes listës së Vuçiqit dhe asaj studentore



Nga A2 CNN

25 Shtator 2026, 08:27 | Politikë



Zgjedhjet parlamentare në Serbi, të caktuara për 25 tetor, rikthyen në vëmendje edhe politikën e Beogradit zyrtar ndaj Kosovës, veçanërisht mes partive dhe nismave politike serbe që veprojnë në Kosovë.

Derisa Lista Serbe mbështet listën Aleksandar Vuçiq - Serbia e Bashkuar, me arsyetimin se ajo nënkupton "vazhdimin e mbështetjes institucionale të Serbisë dhe mbrojtjen e interesave kombëtare serbe", partitë opozitare paralajmërojnë mbështetje për Listën Studentore, duke kritikuar pushtetin aktual në Serbi për, siç thonë, përjashtimin e tyre nga vendimmarrja, mungesën e transparencës në mënyrën se si shpenzohen paratë që Serbia ndan për Kosovën, si dhe për kontroll politik përmes punësimit.

Përveç aktorëve opozitarë në nivel lokal, Listën Studentore e mbështet edhe Partia për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, e udhëhequr nga Nenad Rashić, ministër në Qeverinë e Kosovës të udhëhequr nga Albin Kurti, përcjell A2.

Ai, në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë, thotë se mbështetja për Listën Studentore është e pakushtëzuar, pasi konsideron se është një pikë kthese "të jesh apo të mos jesh" për të gjithë serbët që jetojnë në vendet e rajonit, e në veçanti për ata në Kosovë.

Lëvizja Studentore në Serbi publikoi më herët një memorandum, në të cilin thuhet se "Kosova është pjesë përbërëse e Serbisë" - gjë që nxiti kritika nga një pjesë e opinionit publik në Kosovë dhe në Serbi.

Kjo lëvizje u krijua rreth dy vjet më parë, kur studentët në gjithë Serbinë kërkuan përgjegjësi pas vdekjes së 16 personave si pasojë e shembjes së një strehe në Stacionin Hekurudhor në Novi Sad.

Politologu serb, Ognjen Gogić, vlerëson se Kosova, deri më tani, nuk është ndër temat kryesore të fushatës parazgjedhore në Serbi.

"Partia në pushtet po përqendrohet më shumë te votuesit në Serbi, të cilët janë më të shumtë sesa në Kosovë, prandaj është e mundur që aktiviteti i pushtetit për mobilizimin e serbëve të Kosovës të jetë disi më i vogël, pasi ata, thjesht, nuk përbëjnë një pjesë të rëndësishme të elektoratit", thotë Gogić për Radion Evropa e Lirë.

Ai, gjithashtu, vëren se mbështetja për Listën Studentore nga Kosova nuk ka marrë vëmendje në Serbi dhe se as vetë lëvizja nuk e ka vënë në pah atë.

"Çështja është se sa qytetarë të Serbisë janë fare në dijeni të kësaj mbështetjeje; duket sikur Kosova nuk është vënë në plan të parë", shton Gogić.

Lista Serbe: Mbështetja për listën e Vuçiqit është e rëndësishme për serbët në Kosovë
Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, e cila u formua me mbështetjen e Beogradit dhe të Partisë Përparimtare Serbe në pushtet në Serbi. thotë se mbështetja për

TE FUNDIT

Trump i dhuron Xi Jinping një skulpturë të shqiponjës, simbolit të SHBA

Armët nga Bosnja dhe lidhjet e rrjeteve kriminale në Suedi me Iranin

Vuçiq: Do të jap dorëheqjen të dielën, por do të flas me Putinin para përfundimit të mandatit

"Ne nuk zgjedhëm luftën, na sulmuan dhe u mbrojtëm", presidenti iranian: SHBA të vendosë nëse do t'i japë fund

MË TË VIZITUARAT

SHBA-Iran diskutojnë një marrëveshje me faza për të rihapur Hormuzin dhe për ...

"Kam pasur një fëmijëri të mrekullueshme në komunizëm" Melania del sërisht kun...

Protestoi kundër Netanjahut në OKB, arrestohet aktorja e njohur, Susan Sarand...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Ruisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

listën Aleksandar Vuçiq - Serbia e Bashkuar është e rëndësishme për "vazhdimin e mbështetjes institucionale, mbrojtjen e interesave kombëtare serbe dhe ruajtjen e të drejtave, sigurisë dhe kushteve, që populli serb të qëndrojë dhe të vazhdojë të jetojë në këto hapësira".

Lista Serbe, aktualisht, udhëheq të dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë, ndërsa në Kuvendin e Kosovës mban nëntë nga dhjetë ulëset e rezervuara për komunitetin serb.

Shumë zyrtarë të kësaj partie mbajnë njëkohësisht edhe poste në institucionet e Serbisë.

Kryetari i Listës Serbe, Zllatan Ellek, për shembull, drejton Qendrën Klinike-Spitalore në Mitrovicën e Veriut.

"Fitorja e listës Aleksandar Vuçiq - Serbia e Bashkuar nënkupton vazhdimin e politikës së zhvillimit ekonomik, hapjen e vendeve të reja të punës, rritjen e pagave dhe pensione, investime të mëtejshme në shëndetësi, arsim dhe infrastrukturë, si dhe mbështetje më të madhe për familjet serbe dhe komunitetet lokale në Kosovë", sipas Listës Serbe.

Rashiq: Të gjitha kapacitetet po i drejtojmë në mbështetje të Listës Studentore
Rashiq thotë se Partia e tij, për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë ka vendosur që "me të gjitha mjetet që ka në dispozicion, ta mbështesë fuqishëm Listën Studentore" në zgjedhjet e ardhshme në Serbi.

Ai shpjegon se gjatë fushatës zgjedhore do t'i mobilizojë edhe mbështetësit e tij që më 25 tetor të ndajnë kohë për të votuar.

"Pavarësisht se kjo nënkupton të ndahen disa orë për të votuar në Kurshumli apo kudo tjetër, ekziston një vullnet i madh mes mbështetësve tanë për të ndihmuar në këtë proces. Ne do të përdorim metoda të zakonshme, nga angazhimi personal deri tek organizimi i shkuarjes së përbashkët në vendvotime", thotë Rashiq.

Rashiq thotë se motivi kryesor i partisë së tij për ta mbështetur Listën Studentore në zgjedhjet në Serbi, është ndryshimi i politikës së Beogradit zyrtar ndaj Kosovës dhe krijimi i mundësisë që komuniteti serb në Kosovë t'i marrë vetë vendimet që e prekin.

"Institucionet e Kosovës janë të vetmet që na kanë mbetur dhe ne duhet të bëhemi një faktor brenda tyre. Do të doja që Beogradi, nëse vjen deri te ndryshimi i pushtetit, ta kuptojë se ne nuk mund të jemi vëzhgues të heshtur, por duhet të përfshihemi edhe në dialogun që zhvillohet në Bruksel", thotë Rashiq.

Ai thekson se serbët e Kosovës e dinë mirë se çfarë shkruan në Kushtetutën e Serbisë, por edhe në atë të Kosovës, dhe se askush nga Beogradi nuk mund ta njohë më mirë se ata realitetin në terren.

"Komunikimi me serbët e Kosovës duhet të jetë i dyanshëm. Beogradi nuk mund t'i përdorë serbët e Kosovës për interesat e veta, që ata të shërbejnë vetëm si mekanizëm në procesin e afrimit të Serbisë me Bashkimin Evropian", thotë Rashiq.

Vuçkoviq: Më keq se kaq nuk mund të bëhet

Ivan Vučkoviq, udhëheqës i Iniciativës Qytetare "Rrënjët", thotë për Radion Evropa e Lirë se politika shtetërore e Serbisë ndaj Kosovës është e gabuar dhe se autoritetet aktuale e kanë sjellë komunitetin serb në një situatë në të cilën, sipas tij, "po zhduket dalëngadalë".

Ai thotë se, pas shpalljes së zgjedhjeve në Serbi, nuk e ka parë të nevojshme ta theksojë veçmas mbështetjen për Listën Studentore, pasi, siç shprehet, këtë lëvizje e mbështet që nga themelimi i saj, rreth dy vjet më parë.

"Jam plotësisht i bindur se politika ndaj Kosovës do të ndryshojë nëse ndryshon pushteti [në Serbi]. Ne mbështesim të rinjtë dhe profesionalizmin, ndërsa tani kemi parë edhe listën, e cila i ka konfirmuar pritjet tona. Secili duhet të marrë përgjegjësi dhe të përpiqemi të përballemi me këtë situatë të vështirë. Ne, serbët në Kosovë, jemi në një situatë pa rrugëdalje dhe nuk kam dyshim se diçka do të ndryshojë, sepse më keq se kaq nuk mund të bëhet", thotë Vučkoviq.

Gjatë dy-tre vjetëve të fundit, pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë janë përballur, ndër të tjera, me mbylljen e institucioneve të Serbisë.

Hapat e autoriteteve të Kosovës për shtrirjen e autoritetit edhe në veri të vendit, ata i kanë interpretuar kryesisht si "formë represioni".

Lufta kundër korrupsionit, çështje e rëndësishme edhe për serbët në Kosovë

Programi i Listës Studentore është i përqendruar kryesisht në luftën kundër korrupsionit në institucione, ndërsa Vuçković thekson se kjo çështje është e rëndësishme edhe për komunat me shumicë serbe në Kosovë, të cilat udhëhiqen nga Lista Serbe.

“Korrupsioni duhet të çrënjësohet. Paratë që vijnë nga Serbia duhet të shpërndahen në mënyrë më të barabartë. Konkursët duhet të shpallen rregullisht dhe në punë duhet të pranohen më të mirët, e jo më të përshtatshmit politikisht. Në anën tjetër, të gjithë ata që janë të punësuar, duhet të fillojnë edhe të punojnë, e jo vetëm të marrin paga. Duhet të përpiqemi që, përmes një qasjeje tjetër, serbët në Kosovë të marrin përgjegjësinë për të vendosur për jetën e tyre, që propozimet të vijnë prej këtu dhe jo prej Beogradit”, thotë Vuçković.

Radio Evropa e Lirë ka raportuar disa herë për raste kur paratë e buxhetit të Serbisë të destinuar për Kosovën, janë shpenzuar në mënyra të dyshimta, si dhe për kompani të caktuara që kanë fituar tenderë prej miliona eurosh për projekte që nuk ekzistojnë në terren.

Vuçković, ndër të tjera, pret që, nëse ndryshon pushteti në Serbi, të përballen me përgjegjësi ligjore të gjithë ata që kanë qenë të përfshirë në korrupsion edhe në Kosovë.

Gogiq, në anë tjetër, thotë se është ende herët të flitet për ndryshime të mundshme.

Megjithatë, sipas tij, nëse ndryshon pushteti në Serbi, mund të pritët që të hetohet puna e Listës Serbe në Kosovë, përfshirë mënyrën se si ajo i ka shpenzuar paratë nga buxheti i Serbisë.

“Do të hapet çështja e përgjegjësisë, transparencës dhe politikës ndaj serbëve në Kosovë”, shpreh bindjen Gogiq.

Por, për të nuk është befasi që opozita serbe në Kosovë e mbështet Listën Studentore, pasi këto parti janë kundërshtarë të Listës Serbe, e cila gëzon mbështetjen e autoriteteve aktuale në Serbi.

Kush tjetër mbështet Listën Studentore?

Lëvizja Popullore Serbe tha se i jep mbështetje të plotë Listës Studentore, pasi, sipas saj, “politika tradhtarë dhe menaxhimi i papërgjegjshëm i çështjes së ‘Kosovës e Metohisë’ kanë çuar në situatën në të cilën ndodhemi sot”.

“Kjo nuk është vetëm mbështetje për një listë zgjedhore. Është mbështetje për ndryshimin, përgjegjësinë dhe të drejtën e qytetarëve që të vendosin vetë për të ardhmen e tyre”, thuhet në deklaratë.

Edhe Iniciativa Qytetare “Veriu për të gjithë” u bëri thirrje mbështetësve të saj që ta mbështesin pa rezervë Listën Studentore, duke pretenduar se “Partia Përparimtare Serbe dhe Lista Serbe e kanë sjellë popullin serb në Kosovë në pozitën më të vështirë që nga viti 1999”.

“Institucionet janë shkatërruar, besimi i qytetarëve është tradhtuar, ndërsa hapësira në të cilën jeton populli serb, që sot është më i paktë në numër se kurrë më parë, po ngushtohet çdo ditë. Vazhdimi i një politike të tillë nuk sjell asgjë tjetër përveç humbjeve të mëtejshme, si për serbët në Kosovë, ashtu edhe për popullin serb në tërësi”, thuhet në deklaratë.

Për të njëjtat arsye, mbështetje për Listën Studentore shprehën edhe Demokracia Serbe dhe Aleanca e Kosovës./ **REL (A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream





MUND TE LEXONI GJITHASHTU



6 tetori, afati fundit për Presidentin. Gjykata vendosi: Zgjedhja e qeverisë nuk shkeli Kushtetutën



Trump falënderon Kosovën për kontributin me trupa në Bordin e Paqes



Takime të ndara me Kurtin dhe Vuçiç, Kallas kërkon përparim në dialog



E ardhmja e Gjykatës Speciale, Kusari-Lila: Duhet menduar mirë hapat e radhës



Çfarë parashikon nisma e PDK-së për ndryshime në ligjin për Specialen?



Fati i ish-krerëve të UÇK, Hamza: Presim që Apeli të vendosë mbi bazën e fakteve

Latest Videos



"Rusia kërcënon Ballkanin", Bolton paralajmëron: Situata do të përshkallëzohet, NATO do të kriset



"Mbrohuni, blini më shumë armë", Bolton zbulon ultimatumin e Trump për BE: Pse kërkoi më shumë para





**"Çfarë i ka premtuar Trump Putinit?" Bolton zbulon
prapaskenat: S'ka pasur kurrë marrëveshje, por...**



**"Regjimi iranian drejt rënies?" Bolton zbulon skenarët:Lufta
ka marrë tjetër drejtim Trump ka plan të**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.